

KOMUNA E NOVOBËRDËS 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

Hyrje

Komuna e Novobërdës udhëhiqet nga Svetislav Ivanoviç nga Iniciativa Qytetare Serbe. Ky është mandati i tij i parë.

Në zgjedhjet e kaluara komunale, kandidatët për kryetar kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.¹ Mbi 72% e qytetarëve të Novobërdës besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.² Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Novobërdës me pushtetin lokal, Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale, del se ka ulje të theksuar të kënaqshmërisë nga 18.89 pikë në vitin 2012 në -27.95 në vitin 2015.³

Vlerësimet e bëra nga Instituti GAP në fund të vitit 2013 tregonin se problemet kryesore në atë kohë në këtë komunë kanë qenë mungesa e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujësjellësit dhe kanalizimit, mungesa e gjimnazit dhe çerdheve, mungesa e shërbimeve mjekësore dhe madhësia e administratës publike.⁴

¹ Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësive: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

² Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burim: <http://bit.ly/2wkuTnr> (Hapur më 28 qershor 2017)

³ Ibid. faqe 39

⁴ Instituti GAP, Komuna e Novobërdës: problemet kryesore dhe trendet buxhetor. Burimi: <http://bit.ly/2tpblul>

Problemet aktuale të Komunës së Novobërdës

Mungesa e ujësjellësit

Banorët e Komunës së Novobërdës ballafaqohen me mungesë të sistemit të ujësjellësit. Ujësjellësi mungon në fshatrat Llabjan, Bursë, Kosac, Dikovit, Koloni e re dhe e vjetër. Edhe pse komuna tani më ka nënshkruar marrëveshje për riparimin e ujësjellësit me KRU "Hidromorava", ajo akoma nuk ka përfaqësues në këtë kompani.

Mungesa e shërbimeve shëndetësore

Qytetarëve të Komunës së Novobërdës u ofrohen shërbime shëndetësore në pesë qendra të mjekësisë familjare në fshatrat Llabjan, Prekoc, Jasenovik, Kufcë dhe Koretishtë dhe në shtëpinë e shëndetit në Novobërdë e cila ofron shërbime 24 orë, përderisa qendrat shëndetësore punojnë vetëm tetë orë në ditë. Rrjedhimisht, qytetarët kanë theksuar si problem mos ofrimin e shërbimeve shëndetësore 24 orë në ditë edhe në këto qendra. Problem tjetër i theksuar nga qytetarët është edhe mungesa e shërbimeve gjinekologjike e cila është ofruar në fshatin Prekoc, mirëpo në mungesë të mjekut specialist ky shërbim nuk ekziston më. Banorët e kësaj komune janë të detyruar që këtë shërbim ta kërkojnë në Gjilan apo në Prishtinë.

Mungesa e kanalizimit

Problem tjetër i qytetarëve të Komunës së Novobërdës është edhe mungesa e kanalizimeve dhe trajtimi i ujërave të zeza. Fshatrat Llabjan dhe Lajshevcë, në mungesë të kanalizimit kanë hapur gropa septike të cilat po dëmtojnë tokat bujqësore. Edhe në raportin e MAPL-së mbi performancën e komunave për vitin 2016, si arritje e dobët është vlerësuar trajtimi i ujërave të zeza.⁵

Nevoja për promovimin e turizmit

Komuna e Novobërdës ka potencial shumë të mirë për zhvillimin e turizmit malor. Përpos kalasë së Novobërdës e cila është edhe një nga atraksionet e rralla turistike të kësaj natyre në Kosovë, në këtë komunë ka vende të tjera me potencial për zhvillim të turizmit. Qytetarët e kësaj komune kanë vlerësuar si problem mungesën e promovimit të turizmit si dhe ngritjen e kapaciteteve të banorëve përmes trajnimeve që kanë të bëjnë më zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e trashëgimisë.

Mos vënia në funksion e shtëpisë së pleqve

Objekti i shtëpisë së pleqve në fshatin Prekoc është ndërtuar më ndihmën e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe akoma nuk

⁵ MAPL, Raporti i Përformacës së Komunave 2016. Burimi: <http://bit.ly/2t297r8>, faqe 100

është vënë në funksion. Në këtë shtëpi janë paraparë që të punësohen rreth dhjetë persona. Objekti është ndërtuar mirëpo komuna dhe ministria akoma nuk e kanë funksionalizuar për përdorim të qytetarëve.

Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

Ndalja e prerjes së pyjeve

Që nga viti 2012, komunat kanë përgjegjësi direkte në parandalimin e prerjes së pyjeve në mënyrë ilegale. Komuna e Novobërdës në vitet e fundit i është ekspozuar dukurisë së shkatërrimit të pyjeve. Dëmtimi i kësaj pasurie konsiderohet edhe si faktor i cili mund të dëmtojë potencialin e kësaj komune në zhvillimin e turizmit.

Ndalja e bashkëpunimit me strukturat paralele

Komuna duhet të ndalë bashkëpunimin me të gjitha organizatat, qendrat dhe kompanitë të cilat janë nën udhëheqjen e strukturave paralele të financuara nga Serbia. Komuna në disa raste ka bashkëpunuar me këto qendra me qëllim të kryerjes së punëve të ndryshme. Kjo praktikë duhet të ndalet dhe duhet shikuar format e ndëshkimit ndaj operatorëve që ofrojnë shërbime pa qenë të kontraktuara nga komuna.

Trendet buxhetore në Komunën e Novobërdës (2017)


Buxheti total i planifikuar për Komunën e Novobërdës në vitin 2017 është rreth 2.3 milionë euro.⁶ Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 41 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,⁷ ndërsa në vitin 2013 janë bartur rreth 30 mijë euro më shumë se këtë vit.⁸ Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Novobërdës ka pasur një ulje të lehtë të buxhetit për rreth 77 mijë euro.

⁶ Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2tsvCW3>

⁷ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63


⁸ Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArjf>, faqe 60

Figura nr.1: Buxheti i Komunës së Novobërdës 2017



Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Novobërdës ka shpenzuar pjesën më të madhe të buxhetit në paga dhe mëditje dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë vitit 2014 ka pasur rënie, për të shënuar ngritje në 2017.


Figura nr.2: Trendët buxhetore në komunën e Novobërdës 2013 dhe 2017



Kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga rreth 1.5 milionë euro në 2013 në rreth 1.8 milionë euro në 2017. Kjo rritje mund t'i adresohet vendimit të kryeministrit në vitin 2014⁹ për të rritur pagat në sektorin publik dhe një pjesë e rritjes vjen si rezultat i punësimit të një punëtori më shumë në vitin 2017.

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Novobërda ka pasur ulje rreth 200 mijë euro duke përbërë vetëm rreth 16% të buxhetit. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka pësuar rënie të madhe për rreth 80 mijë euro dhe pjesëmarrja në buxhetin total të komunës është më pak se 1%, ndërkaq para katër vitesh ishte 4%.


Figura nr.3: Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Komuna e Novobërdës gjatë vitit 2016 ka shënuar përparim sa i përket të hyrave komunale. Në 2016 janë realizuar 237 mijë euro, apo rreth 84 mijë euro më shumë të hyra komunale sesa gjatë vitit 2013.

⁹ Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë . Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>

Figura nr.4: Të hyrat vetanake në Komunën e Novobërdës 2013-2016



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

Rekomandimet

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerr këto veprime:

- Komuna e Novobërdës duhet të shohë mundësinë që përmes donatorëve ose nga ministritë e linjës të investojë në zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet që akoma nuk kanë ujë të pijes.
- Komuna duhet të shtojë orarin e punës në ambulancat e fshatrave nga tetë orë sa është aktualisht në 16 orë.
- Komuna duhet t'i vlerësojë potencialet e turizmit dhe të investojë në ato projekte që do ta bënin tërheqëse për turistët këtë komunë.
- Komuna duhet të rikthejë në funksion shtëpinë e pleqve.
- Komuna duhet të ndërmarrë masa urgjente për ta parandaluar prerjen e pyjeve.
- Komuna duhet të ndërpresë çdo bashkëpunim me strukturat paralele.

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world